

## KOLEC TOPALLI

## NGA VEPRA FJALOR ETIMOLOGJIK I GJUHËS SHQIPE V

## L

**lakút** m. “llupës, grykës”. Fjalë kryesisht e toskërishtes. Është formim i brendshëm me parashtesën *la-* dhe emrin *kut* me kuptimin “krah”, i cili, bashkë me emrin “dorë” merret si simbol i vjedhjes. Kësisoj, *lakut* lidhet përbrenda gjuhës me *makut*, që ka të njëjtin kuptim, por ka marrë parashtesë tjetër. Rrjedhoja *lakutëri* është formuar si të gjithë emrat abstraktë (-*ër* + -*i*).

**lapër** m. “leckaman”, “rrugaç”. Fjalë dialektore e gegërishtes, që fjalori i Bashkimit e jep me “i pagdhendur, i ndytë, leshko, zhelan, horr”. Është formim i brendshëm nga emri *lapë* “lapër, copë lëkure, zhangël, zhapë”, që ka marrë prapashtesën -*er*, duke kaluar kuptimisht nga “lapër” në “leckë” e prej kësaj në “leckaman, zhelan, rrugaç”. Lidhet brenda gjuhës me mbiemrin *lapanjos* “ai që bën punë të liga, i ndyrë, i paturp” dhe me foljen *lparos* “fliq, përlyej”. Format e mocionit janë *lapere* e *lapericë*.

**lapurák** m., mb. Si emër “lakuriqi i natës”, “një lloj kërmilli pa guaskë, jargës”; si mbiemër “që i kanë rënë puplat, qafërrjepur”, fig. “i zhveshur”, “i varfër”. Të gjitha këto kuptime të ndryshme të fjalës lidhen me konceptin “lëkurë”, që qëndron në temën *lapër* “copë e vogël lëkure”, “çdo gjë e hollë e petashuqe si lapë”, që ka marrë prapashtesën -*ak*. Lakuriqi i natës e ka marrë këtë emër nga lëkura e krahëve, prej së cilës quhet edhe *lakuriq*. Kërmilli e ka marrë këtë emër nga “lakuriq, pa guaskë, pa mbulojë”. Prej kuptimit “lakuriq” që ka marrë *lapër-a* ka dalë kuptimi “i zhveshur”, fig. “i varfër”, për shpendët edhe “qafërrjepur, që i kanë rënë puplat”. (Luka III 11).

**laurëshë** f. “çafkëlore, lat. *Alauda cristata*”. Fjalë e dy dialekteve. Për Veriun e ka Gazulli për Shllak. Mund të jetë formim i brendshëm me prapashtesën e mocionit -*eshë* nga emri *lahur* “shami me xhufka, peshqir me thekë”, duke u emërtuar ky zog nga xhufka që ka në kokë. Formën e pazgjeruar *lore* e ka Puka (Gazulli). Me këtë lidhet *lorëz* “shpend i vogël nate, që këndon me zë të përvojshëm”, që ka krijuar foljen *lorëzoj* “këndon lorëza”, fig. “qaj si lorëza”.

**lej** fol. “lind”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga fondi indoeuropian. Lidhet përbrenda gjuhës me foljen *lind*, që ka të njëjtin kuptim, dhe përjashta shqipes me rrënjën \**leid<sup>h</sup>*- “rrihem, ngrihem”, ku bëjnë pjesë ind. vj. *ródhati*, *róhati* “ngrihet, rritet”, lat. *liberōrum*, “fëmijët”, got. *liudan*

“rritem, sll. vj. kisht. *ljudbje* “gjinde, njerëz” (Jokl). Raporti i foljeve *lej* e *lind* është i tillë: te *lej* ka rënë -*d*-ja fundore si mbylltore e zëshme, te *lind* është ruajtur, meqenëse ka qenë në një grup bashkëtingëllor, ku -*n*-ja është epentezë. Rruga e ndjekur në këtë rast është e njëjtë me *be* e *bind* nga rrënja ie. \**beid-* “bindem, besoj”. Arbërishtja ka edhe formën joveprorë: *i bardhë u leshë, i zi u ndodhshë* (Reinhold); *hera kūr u leve* (Skiro). Çabej e lidh përbrenda shqipes me emrin *lagje* nga një bazë *legniō*. Dëshmohet së pari te Buzuku: *e gruoja jote Elisabeta të lenjë një djalë*. (Meyer EW 241, Jokl Stud. 48, LKU 42, Weigand Wört. 46, Walde-Pokorny II 416, Walde-Hofmann I 791, Berneker I 758, Tagliavini AD 170, La Piana SLA Varia 29, Çabej SF 2, 1964, 18, Camaj AW 74, Janson 86, Demiraj AE 235, Orel AED 217).

**lërë** f. “grumbull gurësh, vend i thyer me gurë”. Fjalë kryesisht e gegërishtes veriore (Bashkimi), e njohur edhe në toskërishte, ku *lerë* ka kuptimin “një masë dheu që rrëshqet” (Opar, Skrapar). Mund të jetë me burim nga *lerë* “baltë, llucë, gjithçka që sjellin përrrenjtë (gurë, drurë, baltë), duke u specializuar për “grumbull gurësh” e prej këndeje edhe për “vend i thyer me gurë, dhë që rrëshqet”. Kësisoj, *lerë* për “baltë”, “gurë” e “drurë” janë një fjalë e vetme. Jokli e afroi me gr. (hom.) *λαῖα* “gur”. Rrjedhoja **leranë** për “vend i pjerrët me gurë të rënë nga mali” ka marrë prapashtesën -*anë* (khs. *rrethanë*). (Jokl RIÉB 3-4, 1936, 46, Walde-Hofmann I 777, Orel AED 219, Çabej SE V dg. 383).

**lë** fol. “nuk e marr diçka”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga fondi indoeuropian. Ndryshe nga Çabej, që e lidh me lat. *lenis* “i butë”, *lë* mund të lidhet me rrënjën *lē(i)d-* “lë” e “lodh”, ku bëjnë pjesë got. *lētan* e gjerm. *lassen* “lë”, nord. e vj. *latr* “i plogët, përtac”, lat. *lassus* “i lodhur, i këputur”, gr. *ληθεῖν* “lodhem”. Përbrenda gjuhës lidhet me foljen **lodh**, kuptim që e kanë edhe disa gjuhë të tjera. Raporti fonetik *lë* ~ *lodh* është i tillë: në një formë *led-* / *lēd-*, ndërsa në formën e parë ka rënë -*d*-ja fundore si mbylltore e zëshme (*lâ* < \**la-n* ~ *le-n*), në formën e dytë dhëmborja u shndërrua që herët në fërkimore duke u ruajtur (*lodh*). Morfologjikisht, ndërsa toskërishtja i ka rrafshuar ndryshimet vetore të së tashmes (v. I, II, III *lë*), gegërishtja i ka ruajtur dallimet e moçme, ku v. II e III dalin me zanoren -*e* (*len*), kurse veta I ka zanoren -*a* (*lâ*), që e ka edhe e kryera e thjeshtë *lashë* (formë e aoristit sigmatik) dhe pjesorja *lanë*, duke qëndruar këto forma me zanoren -*a* në marrëdhënie apofonike me trajtën e v. II, III me zanoren -*e*-. Format e së tashmes, ndryshe nga e kryera e thjeshtë, dalin me zanore hundore për shkak të mbaresës -*n*, që marrin disa folje në të tashmen (khs. *dua*, *thua*). (Bopp 530, Meyer EW 242, Brugmann Gr. I<sup>2</sup> 133, Weigand Wört. 45, Jokl LKU 252, Walde-Pokorny II 395, Walde-Hofmann I 768, La Piana SLA I 34, Çabej SF 2, 1964, 24, Camaj AW 24, Janson 81, Demiraj AE 239, Orel AED 220).

**lëbógër** shm. “lëvorja e trungut a e degëve të drurëve, cipa e jashtme e frutave; lëvozhga e vezës”. Fjalë e gegërishtes veriore, që del edhe me formën *lbogur* (Gazulli). Lidhet përbrenda gjuhës me emrin *lbokë* “lëvore e hollë pemësh”, me foljen *me lbogurue* “me qërue një pemë” e më tej me *blogur-a* “lëkurë, lëvore” (*blogur hudre, molle, groshe, ahu*), me foljen *me zblogurue* “me hjekë lbogurat”. Në të gjitha këto, forma bazë është *blokë*, formim i brendshëm nga rrënja \**blo-* “bluaj” me prapashtesën *-kë*. Kuptimi “lëvore, lëvozhgë, lëmishte” ka dalë nga ai i një gjëje të bluar imët. Format me *-r* (*blokëra, blogur*) kanë marrë prapashtesën *-r* (khs. *flegër*). Format që nisin me *l-*, janë përfutur me anë të metatezës (*lbokë* nga *blokë*, *lbogur* nga *blogur*), ose me shtesën e parashtesës *lë-* (geg.), që ka shkaktuar zhdukjen disimilatore të lëngzores në rrënjë (\**lëblogur* > *lbogur*). Kësisoj, fjala shpjegohet me mjetet e brendshme të shqipes. Çabej e merr për një huazim nga sll. (skr.) *lùbura* “shportë e vogël me lëkurë drurësh”. (La Piana AN V 1957, 13, Ölberg IBK 13, 1967, 60, Çabej SE V dg. 365).

**lëpê-ja** f. “mjegull e hollë, tis mjegulle, perde në sy”. Fjalë e gegërishtes veriore, që mungon tek autorët e vjetër; sot e vjetruar. Mund të jetë formim i brendshëm i gjuhës nga *lapë* me kuptimin “copë, perde, diçka e zgjatur dhe e gjerë, shirit”. Mjegulla dhe reja shpesh emërtohen *pëlhurë* ose *tis* “napë e hollë, cipë”; khs. në ciklin e kreshnikëve: *sa shpejt diellin ma xu reja! / Shpejt ma endi 'i pëlhurë t'gjanë e t'gjatë*. Me kuptimin e një shiriti a të një lape përdoret edhe për “horizont” (Elezi), për të cilën ka edhe *lëpith* nga e njëjta rrënjë. Fundorja *-ê* mund të ketë dalë nga prapashtesa *-in(ë)*, khs. *mjegullinë*, me një shqiptim dialektor të disa krahinave veriore (khs. *Balldrë* nga *ballë Drin*) duke u ndikuar edhe nga emri *rê*. Një mundësi tjetër është nga forma e shumësit *lëpej*, që e jep Cordignanoja, duke qenë kështu një shumës i singularizuar. Forma *lëpezë* “mjegull e hollë” ka marrë prapashtesë deminutive. Çabej mendon për një lidhje me grupin baltik, prus. vj. *pannean* “kënetë”, let. *panska* “llogaç”. (Çabej SE V dg. 437).

**lëvózhgë** f. “mbulesa e fortë që mbështjell kokrrën e disa pemëve, lëkurë”, “llapusha e kallirit të misrit”, “lëkura e drurëve”, “pare peshku”, “korja e tokës” etj. Fjalë e mbarë gjuhës, që nëpër të folme dialektore del me forma të shumta: *lëvexhgë, lëvyshgë, lëvoçkë, lëveshgë, livoshgë, vëloçgë, luveshgë, gëlvoxhë, vleshgë, gëlvojkë, gëvoxhë, livoçgë* etj. Të gjitha këto shpjegohen me zhvillimet dialektore të një forme të vetme *lëvoshgë*, e formuar nga *lë-vosh-gë*, ku mund të dallohet parashtesa *lë-*, rrënja *vosh*, formë me apofoni e foljes *vesh* dhe prapashtesa *-gë*. Kësisoj, *lëvozhga* është veshja, mbulesa e kokrrës, e drurëve etj. Trajtën \**vosh* të foljes *vesh* e gjejmë edhe në një fjalë tjetër të shqipes, te folja *xhvoshk*, që analizohet në parashtesën *xh-*, që i jep fjalës kuptim të kundërt, në rrënjën \**vosh* të foljes *vesh*, dhe në

prapashtesën *-k*, që mund të jetë e njëjtë me atë të emrit *lëvozhgë*, me një veprim të dyanshëm asimilues: te *lëvozhgë* me asimilim të *sh-së* nga *-g-ja* duke e kthyer nga e shurdhët në të zëshme; te *xhvoshk* me asimilim të *-gë-së* nga *-sh-ja* duke e kthyer nga e zëshme në të shurdhët. Të gjitha format dialektore janë të shpjgueshme: Format me *li-*, *lu-* janë variante të parashtesës *lë-*; ato me *-zh-*, *-xh-* e kanë kthyer bashkëtingëlloren e shurdhët *-sh-* në të zëshme me anë të asimilimit; format me *-ç-* e kanë kthyer fërkimoren *-sh-* në afrikate; format me zanoren *-e-* përmbajnë foljen *vesh*; kurse ato me *vë-* nistore kanë dalë me anë të metatezës. Një formë tjetër dialektore, që lidhet me *lëvozhgë*, është *gëlvozhdë* e geg. VP, që përmban parashtesën *gël-* nga bashkimi *gë- + lë-*, duke shkaktuar shndërrimin *-gë > -dë* në prapashtesë për efekt disimilues nga prania e dy bashkëtingëlloreve të njëjta (*gëlvozhgë > gëlvozhdë*). Folja *lëvozhgë* “i heq lëvozhgën, xhvoshk” ka dalë nga emri (folje prejemerore). (Meyer EW 476, Çabej SF 2, 1964, 29, Camaj AW 109, Orel AED 226).

**lëvrinj** fol. “lëviz shpejt”. Fjalë e mbarë gjuhës. Është formim i brendshëm i shqipes nga folja *lëvroj* me ndërrim prapashtese e paradigme (khs. *bubullin* e *bubullon*) dhe me ndryshim kuptimi. Gegërishtja veriore ka *livroj* me të njëjtin kuptim. Një burim nga it. *liberare* (Meyer, Helbig, Çabej) nuk qëndron nga asnjë anë. Nga kjo folje e italishtes ka hyrë në gjuhën shqipe **libroj**, që e ka geg. VP, po ashtu edhe Buzuku: *neve na libero përherë*. (Meyer EW 247, Helbig 68, Çabej SE V dg. 412).

**lódër** f. “send për të luajtur, lojë”, “daulle”. Fjalë e mbarë gjuhës, forma më e vjetër e së cilës ka qenë *lodrë*, ashtu si *Shkodrë ~ Shkodra*. Me këtë formë dëshmohet së pari te Buzuku: *na qi për endenë lodrët të katit; zgjidh të enlidhunitë e lodrësë*. Është fjalë e trashëguar, që lidhet me rrënjën ie. *lëid<sup>h</sup>* “rritem”, ku bëjnë pjesë irl. vj. *luaid* “lëviz”, *imluadi* “vë në lëvizje”. Ka marrë prapashtesën *-r(ë)*. Përbrenda gjuhës lidhet me foljet *luaj / luej* e *loz*. Raporti i tyre është i tillë: te folja *luaj / luej* (ie. *léd-*) ka rënë *-d-ja* fundore si mbylltore e zëshme me fuqi të dobët shqiptimi dhe folja ka marrë formantin *-n* të foljeve, që ka shkaktuar diftongimin e zanores *-o-*; te *loz* (ie. *léd-iō*) bashkëtingëlloren *-d-* është shkruar me mbare të vetës I numër njëjës duke dhënë një fërkimore, njëlloj si në rastin *mas* nga *mat-iō*; te *lodrë* është ruajtur *-d-ja* duke mos qenë fundore, për hir të prapashtesës *-r(ë)* që ka marrë. Rrjedhoja të fjalës janë: **lodroj** me prapashtesën *-o* të foljeve, prej së cilës kanë dalë emrat **lodrim** e **lodrues**; **lodërz** me prapashtesën deminutive, që përdoret si eufemizëm edhe për sëmundjen e tokës, epilepsinë; **lodërtar** “ai që i bie daulles” me prapashtesën *-tar*; **lodërti** “daulle e madhe”, e formuar me rrugë prapashkuese nga shumësi me *-inj* (khs. *çapî ~ çapinj*) me shtesën e një *-t-je*, mbase nga ndikimi i rrjedhës *lodërtar*. Del së pari te Buzuku: *gjegj lodërtitë e valletë*. Emrin *lodërtar* e ka Budi: *të vinjënë lodërtarëtë* (SC). (Camaj AW 124).

**luár ~ lóri** m. “lopar, bari lopësh”. Fjalë e dy dialekteve bashkë me emrin përmbledhës **luarí** “tufë lopësh”, që arbërishtja e Greqisë e ka me formën *luaré*, me prapashtesën *-e*. Fjala gjendet në të dy dialektet me diftongun *-ua-*, si rrjedhim, nuk kemi diftongim të zanores *-o-* në *-ua-*, që në gegërishte do të jepte *\*\*luer ~ lori*. Prandaj tjetër shpjegim ka diftongu *-ua-*, që shfaqet në emrin e katundit **Luari** të Shqipërisë së Mesme, në emrin e vëllazërisë **Luhari** në Mal të Zi me bashkëtingëlloren *-h-* për zhdukje të hiatit, në emrin e fshatit **Luarzë** në afërsi të Velipojës etj. Për burimin e fjalës, ndryshe nga Çabej, që e merr për huazim nga sll. (skr.) *lugar*, duke u mbështetur në disa raste të tjera, ku një *-ua-* e dy dialekteve ka dalë nga *-v- + zanore* (khs. *kual* nga it. *cavallo*, *luadh* nga gr. *λιβάδι*), *luar* është një formim i brendshëm i shqipes me parashtesën *lë-* dhe foljen *var* (*lë-var > luar*), me kuptimin e parë “tufë, rresht, varg (bagëtish)”, prej të cilit doli “ai që ruan tufën, bari delesh a lopësh, ruajtës bagëtish”. Ky kuptim del sidomos në emrin kolektiv **luarí** “tufë lopësh”, domethënë “varg, vargan lopësh”. Emri **Luaras** i një fshati në Jug, që përdoret edhe si patronim, ka marrë prapashtesën *-as*. (Meyer EW 249, Jokl II XXI, VII, 86, 214, LKU 225, Sandfeld 44, Topalli Dift. 251, Luka III 62, 65, Çabej SE V dg. 441).

**lyej** fol. “bojatis, ngjyros, ndyj”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga fondi indoeuropian. Lidhet me rrënjën *leu-* “ndyrësi, pisllek; ndyj, ndot”, ku bëjnë pjesë gr. *λῦμα* “ndyrësi, turp”, lat. *polluo* “njolloso”, *lutum* “pleh, baltë”, irl. vj. *loth* “pisllek, kym. *lludedic* “me baltë”. Togu zanor *-ye-* me origjinë diftongore është krijuar nga mbaresa *-n-* e sistemit foljor (khs. *thyej, bluaj*). Toskërishtja dhe arbërishtja kanë përgjithësisht formën *liej*, me kthimin e zanores *-y-* në *-i-*, që është dytësore përkundrejt formës *lyej*. Për këtë arsye, një bazë *\*len-*, që lidhet me lat. *lino*, irl. vj. *lenaim* “ndjek” (Çabej), nuk pajtohet me zhvillimin fonetik të fjalës. Fjala dëshmohej së pari te Buzuku: *bani baltë e leu sytë e mī*. Rrjedhoja të fjalës janë, a) me prapashtesa: **lyes** (geg.) e **lyerës** (tosk.) “ngjyruer, bojaxhi” nga pj. *lye(rë) + -s, lyerje* nga *lyer + -je*; b) me parashtesa: **i palyer** nga mbiemërzimi i formës së pashtjelluar *pa lyer*; **përlyej** “e ndot, e fëlliq; e bëj me lyre” me rrjedhojat **përlyerje, i papërlyer; shlyej, shlyerje, i pashlyer, i pashlyeshëm; tëlyenë / tëlyerë** (tosk.) “gjalpë, bulmet” nga përngjitja e pjesores me nyjën (*të + lyenë*). Kjo e fundit del që te Buzuku: *Aj kã me ngranë tëlyenë e mjaltë*. Me foljen *lyej* lidhen edhe formimet prapashtesore: **lym** “balta e lumenjve”, **lerë** “baltë e hollë, llucë, lym, pellg me ujë e me baltë” dhe “zhul, zdralë”; **lyrë** “yndyrë”, “gjalpë, dhjamë, vaj”; **lez** “nishan”, **lyth** “kallo”, **lyç** “keq, ngatërruar” etj. (Meyer EW 251, Barić ARS I 50, Jokl LKU 67, Walde-Pokorny II 406, Çabej SF 2, 1964, 35, Camaj AW 125, Ölberg IWA 106, Orel AED 236).

## LL

**llabáne** f. “veshje e sipërme, zakonisht me lesh dhie e pa mëngë, që mbulon kokën e supet; kapuç i madh barinjsh”. Fjalë e dialektit toskë. Është formim i brendshëm i gjuhës nga emri *llapë*, që krahas “gjuhë” ka edhe kuptimin “një copë prej rrobe që përdoret për të mbuluar diçka; copë e zgjatur, që varet në petka”. Ka marrë prapashtesën *-an*. Fundorja *-e* është formanti i emrave të gjinisë femërore.

**llacamán** mb. “qengj që pi për një kohë të gjatë tek e ëma”, “ai të cilit i pëlqejnë ëmbëlsirat”. Fjalë e gjuhës bisedore, e përdorur në gegërishten veriore. Është formim i brendshëm nga emri *llasë* “llastim, përkëdhelje”, shumësi *llasa*, që ka marrë prapashtesën *-man* (khs. *rreckaman*, *leckaman*). Kësisoj, *llacaman* do të thotë “i llastuar, i përkëdhelur”.

## M

**macúrr** m. “koçan misri, misërishte”. Fjalë e dialektit gegë. Është formim me parashtesën *ma-* dhe emri *curr* “shkëmb i lartë e i thepisur, thep, majë”, që në rrjedhojat e saj ka krijuar kuptimet “diçka e prerë, cung”, si: *currak* e *currakët* “që i janë prerë degët”, *curroj* e *curras* “i pres veshët”, *curr* “njeri me veshë të vegjël” etj.

**macarrúngë** f. “pjesë e ënjtur në trup dhe e ngritur si xhungë; gungë”. Fjalë e dialektit gegë, kryesisht e anëve verilindore. Është formim i brendshëm me prapashtesën *-ungë* nga *macurr* “koçan misri” me kuptimin “cung, një e dalë”, vetë kjo nga *curr* “thep, majë”, duke u përshtatur zanoret me harmoni vokalike. Në formimin e saj mund të ketë ndikuar emri *bullungë* “gungë, xhungë”. Në Malësi të Madhe *maçarungë* përdoret me disa kuptime të tjera, që nënkuptojnë gjithnjë një xhungë, si: “larva e bretkocës, kandërr me krye të madh e shtat të vogël”, “mollëza e pipit të duhanit”, “dorëca e shpatës”, “njeri kryemadh” (Gazulli).

**makth** m. “ankth”, “figurë përrallash në fytyrë të njeriut, që vjen natën e të zë frymën”. Fjalë kryesisht e dialektit gegë. Lidhet përbrenda gjuhës me *ankth* “ëndërr e keqe që të zë frymën, shqetësim i madh”. Ka marrë parashtesën *m-*, që ka shkaktuar disimilimin në shkallën zero të sonantes tjetër hundore në trup të fjalës. Emri *ankth* lidhet me rrënjën ie. \**ang-*, ku bëjnë pjesë lat. *angustus* “i ngushtë”, gr. ἄγκω “shtrëngoj me gjalmë, mbyt”, gjerm. *eng* “i ngushtë” etj. (Orel AED 242, Luka III 94).

**malcój** fol. “pezmatoj plagën, e mahis, keqësohet”. Fjalë kryesisht e Shqipërisë së Mesme dhe e toskërishtes veriore. Mund të jetë huazim nga it. *male* “keq” me kuptimin “përkeqësohet (plaga), pezmatohet”. Ka marrë prapashtesën *-(ë)so* të foljeve. Dëshmohet së pari te Budi: *plaga e idhunë sã shpesh lëndonetë aqë mã tepërë malcon*. Ky autor ka edhe emrin *malicje* nga it. *malizia*. Rrjedhoja **malcim** është formuar nga folja. Shpjegimi i Çabejt me mjete të brendshme të shqipes, nga mbiemri *i ambël / i ëmbël* ose nga emri *mal*, nuk të bindin. (Meyer EW 256, Meyer-Lübke REW 5266a, Çabej SF 3, 1964, 16, Mihăescu RĚSEE 1-2, 1966, 23, Haarmann Lat. Lehn. 134, Orel AED 243).

**marxhë** f. “bagëti e ngordhur dhe e rrjepur, bagëti shumë e dobët”. Fjalë dialektore e toskërishtes. Është huazim krahinor prej it. *marcio* “i kalbur, i krimbur, i prishur”.

**mashtrój** fol. “e gënjej, i bëj hile”. Fjalë e mbarë gjuhës. Është huazim nga it. *ammaestrare* “me stërvitë” nga *maestro* “mjeshtrë”. Kthimi *-s-* > *-sh-*, si edhe ndërrimi i kuptimit të fjalës dëshmon se ka hyrë herët në gjuhën shqipe. Forma më e vjetër del te Buzuku: *e en dishiplinet së qiellat na majshtro*. Me këtë formë e ka edhe Budi (SC). Buzuku ka edhe një formë tjetër të kësaj foljeje, më të re, që e ka ruajtur më mirë formën dhe kuptimin e gjuhës huazuese: *tue empsuom e tue amajshtruom ju vetëvetëhenë endë psalma e endë hÿmna*. Ai ka gjithashtu edhe emrin abstrakt *majshtrí* nga it. *maestria: të dashunitë të jetë pa endonjë majshtri*. Rrjedhoja të fjalës janë: **mashtrim**, **mashtrues**, **i mashtruar**, **i pamashtrueshëm**. (Helbig 123, Çabej SE V dg. 520).

**mashúrka** shm. “lloj fasulesh të njoma, bishtaja”. Fjalë krahinore e dialektit toskë, me përdorim kryesisht në anët lindore. Përdoret vetëm në shumë. Nga etimologjitë e paraqitura, afrimi me skr. *mahuna* “bishtajë” (Meyer) nuk qëndron fonetikisht; afrimi me gr. ζύω “kruaj” (Barić) nuk qëndron as kuptimisht; një burim nga *mashë* “gomë, brumë, tutkall” (Orel) nuk përlligjet nga asnjë anë. Çabej e lë pa shpjeguar. Është formim i brendshëm me prapashtesën *-kë* nga emri *masur*, me ndërrimin *-s-* > *-sh-*, që ndodh shpesh në të folme dialektore, si një përzjerje e këtyre tingujve; ose duke u ndikuar nga ndonjë fjalë tjetër (*mashë*). Emërtimi i bishtajave në këtë rast është bërë nga forma e tyre e gjatë në përngjasim të masurit, me të cilin është emërtuar edhe koçani i misrit për të njëjtën arsye. (Meyer EW 287, Barić ARS I 96, Orel AED 247, Çabej SE V dg. 520).

**mavrí** mb. “i pafat, fatkeq, i shkretë”. Fjalë e dialektit toskë dhe e arbërishtes. Është huazim nga gr. μαῦρος “i zi”, fig. “fatkeq”. Përhapja e fjalës në Jug pajtohet me burimin e saj.

**mbarë (i)** mb. “i mirë, i urtë”, “në anën e duhur”. Fjalë e mbarë gjuhës, që përdoret si mbiemër e ndajfolje dhe del me shumë kuptime: *djalë i mbarë, vit i mbarë, me këmbë të mbarë, më shkoi mbarë, e mbaj për mbarë, udha e mbarë, bota mbarë, për së mbari* etj. Dëshmohet së pari te Buzuku: *Noe u njeri i dërejtë e i embarë*. Për burimin e fjalës duhet marrë parasysht antonimi i saj: *i prapë, i mbrapshtë* (khs. *mbarë e mbrapshtë*) duke qëndruar këto dy fjalë si *para e prapa*; si rrjedhim, ndërsa *i mbrapshtë* lidhet me *prapa*, *i mbarë* lidhet me *para, parë*, duke qenë burimi i fjalës numërori *i parë*, që ka krijuar ndajfoljen *para*. Një lidhje e saj me foljen *bār, mbar* nga ie. *b<sup>h</sup>er-* (Meyer, Cimochowski, Çabej) është fonetkisht e rregullt, por jo edhe kuptimisht, prandaj duhet lënë mënjane. Rrjedhoja të fjalës janë: ***mbarësi, mbarësisht, mbarësoj, tumbar*** “e nis a e vë në udhë të mbarë një punë, e vë në vijë”. Ndajfolja ***për së mbari*** është një rrjedhore njëjës me parafjalën *për*, që përdoret edhe me këtë rasë (khs. *i doli për hundësh*). (Camarda I 62, Meyer EW 35, Cimochowski LP 2, 1950, 257, Orel AED 248, Çabej SE V dg. 529).

**mbërdhók** m. “guralec, guraçok”. Fjalë kryesisht e dialektit gegë, që del në Fjalorin e Gazullit dhe te Tase në kompozitën ***kokëmbërdhok*** “kokëfortë”. Është formim i brendshëm nga *papërdhok* “gur zalli i vogël, guralec” dhe “kokërrdhok”, ku ka rënë rrokja e parë me anë të haplologjisë dhe fjala ka marrë protezën e një *m*-je para buzores *p*-. Vetë *papërdhok* ka dalë nga *kokërrdhok* me anë të disimilimit të bashkëtingëlloreve grykore në një fjalë me tri të tilla. Prej *mbërdhok* është formuar ***camërdhok*** “fëmijë i vogël, vocërrak”. (Gazulli 254, Luka III 118).

**mbërthëj** fol. “fut kopsën në ilik, kopsit”, “gozhdoj”, “zë, kap”. Fjalë e mbarë gjuhës. Është formim i brendshëm, burimi i së cilës mund të arrihet duke u nisur nga antonimi i saj ***zbërthej***. Kjo folje është formuar nga folja *thyej* ~ *thej*, që ka marrë parashtesat *z-* e *për-*, e para me kuptim intensiv. Kësisoj, *zbërthej* ka kuptimin “e thyej, e ndaj copa-copa”; khs. edhe ***përthyej*** e ***shpërthej***. Prej *zbërthej* është krijuar antonimi i saj ***mbërthej*** duke zëvendësuar parashtesën *z-* me *m-*. Një dukuri e tillë ka ndodhur edhe me foljet *mbath* e *zbath*, ku parësore është *zbath* (lit. *bāsas* “zbathur”) e prej saj është krijuar *mbath* me ndërrim parashtesash si te *mbërthej* e *zbërthej*. Fjala dëshmohet së pari te Buzuku: *me përzanë letërenë e me çpërthÿem të embërthÿemetë e saj*. Çabej e lidh me foljen *mbath*. Rrjedhoja të fjalës janë: ***mbërthim, mbërtheckë*** “kopsë, sumbull” me prapashtesën *-ckë*, ***të mbërthyerat*** “kyçet e gjymtyrëve”. (Meyer EW 265, Orel AED 250, Çabej SF 3, 1964, 22, Luka III 119).

**mbërríj** fol. “arrij”. Fjalë e gegërishtes, së cilës toskërishtja i përgjigjet me *arrij*. Të dyja këto kanë një rrënjë, por ndryshojnë në parashtesat që kanë marrë. Rrënja e fjalës lidhet përbrenda shqipes me foljen *rri* e përjashta saj me ie. *rē* “pushoj, pushim”, nga e cila kanë dalë nord. vj. *rō*, ags.

*rōw*, gjerm. l. vj. *ruowa*, gjerm. l. re *Ruhe*, të gjitha me të njëjtin kuptim. Lidhja e foljeve *mbërrij* e *rri* është e tillë që *mbërrij* tregon pikën e përfundimit të lëvizjes, domethënë pikën e pushimit, sikurse *rri* tregon qëndrim në vend. Lidhja burimore e kësaj foljeje me mbiemrin *i mbarë*, ashtu si edhe e këtij mbiemri me foljen *bie* ~ *bjerë* (Çabej), nuk janë bindëse, për arsye se *mbërrij* e *arrij* nuk mund të ndahen prej njëra-tjetrës, si rrjedhim, ato kanë një rrënjë të vetme, që nuk mund të dalë nga *i mbarë* dhe as nga *bie*. Rrjedhoja të foljes janë: emri foljor ***mbërritje*** dhe mbiemri ***i mbërrishëm***. Del së pari te Buzuku: *e kÿ sherbëtori yt mundë embërinjë me pasunë të bekuomit e jetësë glatë të qiullet*. E kanë edhe autorët e tjerë. Budi ka edhe mbiemrin foljor *i mbërrishim* (RR) “ai që i vjen në ndihmë dikujt”. (Meyer EW 17, Walde-Pokorny I 144, Çabej SF 3, 1964, 23, Orel AED 250, Luka III 119).

**mbështét / mbështés** fol. “vë diçka përbri një sendi”, “përkrah”. Fjalë e mbarë gjuhës, që gegërishtja e ka me formën *pështes / pështet*. Është folje e prejardhur me parashtesën *mbë-* dhe një rrënjë *shtet*, zanorja e së cilës mund të rrjedhë nga një *-a-*, si në shumë raste të tjera; si rrjedhim, brenda gjuhës mund të afrohet me emrat *shtet* e *shtat* e me foljen *përshtat*, të gjitha me burim nga lat. *status* “qëndrim, pozicion”, pjesorja e shkuar e foljes *sto, -āre* “qëndroj, rri më këmbë”. Lidhjet e tjera janë më të largëta: sipas Joklit lidhet me ndajfoljen *shtuar* “më këmbë”; sipas Çabejt lidhet me foljen *shtyj*. Dëshmohet së pari te Buzuku: *e aj pështetë Zot Zotit tÿ*. Rrjedhoja të fjalës janë: ***mbështetje***, ***mbështetës***, ***i mbështetshëm***, ***i pambështetje***. (Camarda I 62, Jokl LKU 250, Demiraj AE 260, Orel AED 251, Çabej SE VI 219).

**mbles** f. “lajmës, shkues”. Fjalë e dialektit toskë. Është formim i brendshëm nga folja *blej*, që ka marrë prapashtesën *-s* dhe protezën e një *m-*je para bashkëtingëllores *-b-* (khs. geg. *bles* “blerës”). Formimi nga folja *blej* përlijet me zakonin e lashtë, sipas të cilit babai i vajzës merrte para kur bëheshin fejesat. Kësisoj, *mblesi* është ai që hyn ndërmjetës për të blerë një vajzë. Çabej e lidh me foljen *mbloj* “mbush”. Rrjedhoja të fjalës janë: ***mblesës*** “lajmës”, ***mblesë*** e ***mblesëri*** “fejesë me mbles”, ***mblesëroj*** “fejoj dikë me mblesëri”, ***mblesëtar*** “lajmës, mbles”. (Çabej SE V dg. 555).

**mbrámë (i)** mb. “i fundit”. Fjalë e dialektit gegë. Është formim i brendshëm nga *i prapmë* < *prapë* + *-më*, kuptimisht “që është prapa”, fonetikisht me asimilimin e grupit *-pm-* > *-m-*. Lidhet brenda gjuhës me *mbramë* e *mbramje*, që kanë të njëjtin burim.

**mbulój** fol. “i vë përsipër një mbulesë”. Fjalë e mbarë gjuhës. Gegërishtja ka *mloj* nga *mbëloj* me asimilim të grupit *mb-* > *-m* dhe me rënien e zanores së rrëgjuar. Trajtën e fundit e ka Buzuku, ku fjala dëshmohet së pari: *ashtu sã nava ish embëluom valëshit së detit*. Autorët e tjerë të mëvonshëm

kanë trajtën me zanoren *-u-*; Budi: *kafshë të buluome e të mshehuna* (DC); Bardhi: *Me mbuluem* “Tegere”. Bogdani ka formën *mbëloj* të Buzukut: *I mbëluenë faqenë me një të qelbëtë, e të shqerrë pëlhurë*. Burimi i fjalës mund të shpjegohet duke marrë parasysht një folje tjetër që lidhet me të: *bulon* “çelin lulet, drurët etj.: *bulojnë pemët*; formim me prapashtesën *-o* nga emri *bulë*. Nga kjo folje me kuptimin “çel, hap” është formuar së pari *zbulon* me kuptimin konkret “hapin bulat” e me një kuptim më të përgjithshëm “hap, heq mbulojën, gjej”. Prej *zbuloj* është formuar *mbuloj*, si antonim i saj. Një dukuri e tillë ka ndodhur edhe me disa folje të tjera, ku format me *z-* janë parësore, kurse ato me *m-* janë dytësore, të krijuara prej saj. Sjellim si shembull çiftin *mbath* e *zbath*, ku kjo e fundit krahasohet me lit. *bāsas*, let. *bass*, sll. *bosъ*, arm. *bok*, të gjitha me kuptimin “zbathur”, si rrjedhim, më parë është krijuar *zbath* e prej saj *mbath*. Një çift tjetër i tillë është *mbërthej* e *zërthej*, ku kjo e fundit shpjegohet me foljen *thyej* ~ *thej* dhe prej saj është krijuar më vonë *mbërthej*, si antonimi i saj. Madje, dukuria vërtetohet edhe me fjalë që nisin me grykore, siç është rasti *ngatërroj* ~ *shkatërroj*, ku më përpara është formuar *shkatërroj* nga numërori *katër* me kuptimin “e ndaj katër copash” e prej saj ka dalë antonimi *ngatërroj*. Rrjedhoja të fjalës janë: *mbulim*, *mbulesë*, *mbulojë* (khs. *blojë*), *mbulues*, *i mbuluar*, *i pambuluar*. (Camarda I 61, Meyer EW 267, Pedersen KZ 33, 1897, 538, Weigand Wört. 56, Tagliavini AD 187, Çabej SF 3, 1964, 25, Orel AED 253, Luka III 126).

**më / mâ** ndf., psz. “edhe ca; edhe një tjetër; ende”. Fjalë e mbarë gjuhës, që del me ndryshime dialektore duke dëshmuar se ka pasur në fund të saj sonanten *-n* (khs. *zâ / zë*). Është fjalë e trashëguar nga fondi indoeuropian. Lidhet me rrënjën *mei-* “zogëloj, pakësoj” (shq. *\*mei-no*), ku bëjnë pjesë lat. *minor*, *minus* “më i vogël, më i pakët”, ags. *minn* “i vogël, i pakët”. Dëshmohet në njërin nga dokumentet më të hershme të gjuhës shqipe, në Perikopenë e Ungjillit të Shën Mateut: *e ishtë ma kejqe*. E ka edhe Buzuku: *e entherni mëzatnë e mā majm*. Ky autor e përdor edhe në funksion të një ndajfoljeje sasive me kuptimin “më shumë”: *E mā vien një Ungjill o i vobeg, qi anshtë fjala e dërejta e Tinëzot, se gjithë magjitë e ëngjūtë e tū*. Shërben si element formues për shumë fjalë, sidomos për mbiemra: *i mëhershëm*, *i mëvonshëm*, *i mëparshëm*, *i mëpastajmë*, *i mëpastajshëm*, *i mëposhtëm*, *i mësipërm*, *i mëtejshëm*, *i mëtejme*, *i mëtutjemë*, *i mëtutjeshëm* etj. (Bopp 489, Camarda I 21, Meyer EW 271, Meyer-Lübke Gröbers Gr. I<sup>2</sup> 1904-1906, 1042, Weigand Wört. 50, Walde-Pokorny II 242, Tagliavini AD 194, Mann Lg. 17, 1941, 23, Orel AED 258, Çabej SE V dg. 580).

**mëngó** fol. “ngrihem pa zbardhur drita”. Fjalë e mbarë gjuhës, sot jashtë përdorimi. Sipas Meyerit është huazim nga lat. *manicāre* prej *māne* “në mëngjes herët”. Mund të jetë edhe formim i brendshëm i shqipes nga emri *ag*

“mëngjes”, që ka marrë parashtesat *më-* + *në-* dhe prapashtesën *-o* të foljeve. Fjalori i Bashkimit dhe i Cordinanos kanë formën *mëgoj* ~ *me mëgue* për “zbardh drita”, që do të ishte forma pa parashtesën *në-*. Prej *mëngo* është formuar emri *mëngjes* e prej këtij *mjes*, forma e ndërmjetme e së cilës ka qenë *mënjes* (Weigand Wört.). (Meyer EW 272, Puşcariu EW 1084, Jokl MRIW I 1914, 303, Mihăescu RÉSEE 1-2, 1966, 26, Orel AED 261, Çabej SE V dg. 604).

**mëshere** f. “dorëz e vogël djathi”, “rrotull djathi”. Fjalë e dy dialekteve me forma të ndryshme krahinore: *mushere*, *pshere*, *psherë*, *mëshyer*, *mëqere*; me burim të errët. Sipas Çabejt lidhet përbrenda gjuhës me *mëshirë* duke kaluar nëpër shkallët: “mëshirë”: “lëmoshë”: “bukë” : “bukë djathi”: “mëshere”. Sipas Orelit është huazim nga lat. *\*mensōra* për *mensūra* “masë”. Asnjëra nga këto etimologji nuk është bindëse. Prandaj mund të parashtrijmë një hipotezë tjetër. Duke u nisur nga format e ndryshme të fjalës, mund të jenë parësore format me *p-*, kurse ato me *m-* mund të kenë dalë me protezën e *m-së* si në rastin *pësoj* e *mësoj*, *pshij* e *mshij*. Në një formë *pëshere* mund të kemi formim të brendshëm me prapashtesën *-er* ~ *yer* nga emri *peshë*, që përdoret edhe me kuptimin “gur” dhe “gur peshe”, khs. *mos gjuet me pesha* “me gurë”; si rrjedhim, *një mëshere djathë* do të thotë “një dorcë e vogël djathi sa një peshë, sa një gur”. Fonetikisht, ndërrimi *p-* > *m-* në ballë të fjalës ka prekur edhe foljen *peshoj*, që ka krijuar *mëshoj* “rëndo, shtyp”. (Çabej SF 3, 1964, 35, Orel AED 264).

**mështymet** fol. “u ikën lagështia e tepërt druve kur thahen pranë zjarrit”. Fjalë me përhapje krahinore. Është formim i brendshëm i gjuhës, që lidhet me emrin *pështymë* dhe me foljen *pështymet* me të njëjtin kuptim. Semantikisht, burimi nga emri *pështymë* përlijet me faktin se kur thahen drutë pranë zjarrit, nxjerrin ujë në formë flluskash, që i ngjan pështymës. Fonetikisht, *mështymet* e *pështymet* paraqesin të njëjtin zhvillim si *pësoj* e *mësoj*, *peshoj* e *mëshoj* etj.

**mjakë** f. “shkrumbi që zë goja nga ethet ose nga etja e madhe”. Fjalë me përhapje krahinore. Lidhet përbrenda gjuhës me *makë* “cipë që zënë përsipër lëngjet; ngjitës, qiriç”, që është me burim indoeuropian dhe lidhet me rrënjën *mak-* “i qullur, njom”, ku bëjnë pjesë bullg. vj. *mokrъ* “i qullur, i njomur”, lit. *mākas*, *mĕkeris* “qese, kuletë”, kym. *megin* “mëshikë”, gjerm. l. vj. *mago* “stomak”. Diftongi *-ja-* na çon te një bazë *\*mek-*, që brenda gjuhës lidhet me foljen *mekem* me kuptimin e parë “e lag pak, e njom sa të zbutet” nga e njëjta rrënjë, duke u lidhur me *makë* me lidhje apofonike. Nga *mjakë* është formuar folja *mjakem* “më thahet goja, më bëhet shkrumb”.

**myjje** f. “palca ose zemra e drurit; mesi i diçkaje”. Fjalë e dialektit gegë, e trashëguar nga fondi indoeuropian. Fonetikisht, *myjje* ka dalë nga *mye*. Kuptimisht *myjje* do të thotë “mes, midis”: *myeja e kurrizit*, *myeja e Kasnjeti* “qendra”, *myeja e kallnorit*, *myeja e dimnit* “mesi i kallnorit, i dimrit” (Xhuvani). Prandaj brenda gjuhës *myjje* lidhet me *mes*, *mjet* (khs. *ndërmjet*), të cilat i përkasin rrënjës ie. *med<sup>h</sup>*- “mes”, ku bëjnë pjesë ind. vj. *madhya*, av. *maidya*, arm *mēā*, gr. μέσος, lat. *medius*, got. *midjis*, të gjitha me kuptimin “mes, midis”. Baza parashqiptare e fjalës mund të ketë qenë *mōd-*, e cila, me rënien e dhëmbores së zëshme dhe me mbaresën e kallzores së trashëguar (\**mōd-om*), ka përfunduar në *mye*, krejt si lat. *nōdus* ka përfunduar në *nye*. Forma *myjje* nga *mye* është krijuar në trajtën e shquar *mye-j-a*, ashtu si *nyjje* nga *nye-j-a* dhe *Krujje* nga *Krue-j-a*. Me këtë rast, shënojmë se lat. *medulla*, prej së cilës ka dalë it. *midollo* “palcë”, që në Fjalorin Etimologjik të italishtes (Cortelazzo) shënohet me burim të pasigurt, mund të lidhet me lat. *medius* “mes”, ashtu si edhe në gjuhën shqipe. Në të vërtetë, *myja e kurrizit* e shqipes i përgjigjet it. *midollo spinale*, dhe *u laga deri në palcë* i përgjigjet it. *bagnarsi fino al midollo*. Mendimi i Joklit, që e lidh fjalën e shqipes me lit. *mėlynas* “i kaltër”, let. *mėls* “i zi”, prus. *mīlinan* “njollë”, paraqet vështirësi kuptimore e fonetike. I pamundur është edhe huazimi nga lat. *medulla* (Orel). Mbiemri **myjtë** “që është prej myje” ka marrë prapashtesën *-të* të mbiemrave. (Jokl LKU 195, Walde-Pokorny II 261, Walde-Hofmann II 123, Xhuvani SF 3, 1974, 158, Topalli Dift. 189, Orel AED 281, Çabej SE V dg. 714).

## N

**ndërgón** fol. “thith gjirin (për bagëti)”. Fjalë e dialektit gegë. Është formim i brendshëm nga folja *ndrag*, që ka marrë prapashtesën *-o* të foljeve, duke shkaktuar lëvizjen e sonantes lëngëzore brenda rrokjes (khs. *përkoj* nga *prek*, *fërkoj* nga lat. *fricāre*). Çabej e nxjerr nga folja *dëkoj* “derdh” duke e lidhur me emrin *darkë*. (Çabej SE III 219, Luka III 199).

**ndërséj** fol. “nxit qenin për të ndjekur ose për të sulmuar dikë”. Fjalë e mbarë gjuhës, që e ka edhe arbërishtja e Greqisë. Është formim i brendshëm me parashtesën *n(d)ë-* dhe foljen *arsej* me kuptimin “e stërvit, e mësoj”. Forma e sotme me zanore të rrëgjuar mund të jetë rezultat i ndërhyrjes së parafjalës *ndër*. Nga folja janë krijuar emrat **ndërsim** e **ndërsyes**. Çabej e bashkon me foljen *ndërzej* dhe të dyja këto i nxjerr prej foljes *ndez*. (Çabej SE VI 22).

**ndíej** fol. “ndijoj, dëgjoj, marr vesh, kuptoj”. Fjalë e mbarë gjuhës duke përfshirë edhe arbërishten e Italisë e të Greqisë; e trashëguar nga fondi indoeuropian. Dëshkohet së pari te Budi: *Ti me ndiem të xbuluom*. E kanë edhe autorët e tjerë pas tij. Për burimin e fjalës, ndryshe nga Çabej, që e lidh me grupin e lat. *tongeo*, got. *þagkjan*, gjerm. *denken*, mendojmë se **ndiej** i

përket një grupi tjetër fjalësh. Analiza e brendshme dëshmon se *ndiej* ka pasur bashkëtingëlloren *-r* në fund, meqenëse togu zanor *-ie-* ka dalë nga një *\*-ier*; khs. *bie* ~ *bjerë* : ie. *b<sup>h</sup>er-*, *shpie* ~ *shpjerë* : ie. *per-*, *shtie* ~ *shtjerë* : ie. *ster-*. Prandaj baza e *ndie-j* ka qenë një *\*der-*, që ka kaluar nëpër fazat *\*n-der-* > *\*ndier* > *ndie*. Folja *ndiej* ka marrë mbaresën e foljeve me *-nj* > *-j*. Me këtë bazë, një *\*der-*, folja e shqipes mund të ketë pasur një kuptim më konkret për “lëkurë, të prekur në lëkurë” nga rrënja ie. *der-* “rrjep, çaj” duke u lidhur përbrenda shqipes me *zdramë* “plagë që i bëhet kafshës në lëkurë” e *zdralë* “zhuli i lëkurës” e përjashta saj me gr. *δέρω* “rrjep”, *δέρμα* “lëkurë” bret. *dervoeden* “urth”, ags. *teter* “puçriza mbi lëkurë”, lit. *dedervinê* “urth”, sll. vj. kisht. *derp* “shkyej, rrjep”. Rrjedhoja të fjalës janë: (me tog zanor) *i pandier*, *parandiej*; (me diftong): *i ndjeshëm*, *i pandjeshëm*, *pandjeshmëri*, *ndjenjë* nga e tashmja *ndjenj*, *ndjesi* e *pandjesi*; (me zanore të thjeshtë): *ndijë* “ndijim, shqisë” nga *ndie-j-ë* (si *blojë*, *brejë*), folja *ndijoj*, emri *ndijim* e mbiemri *ndijor*. (Camarda I 81, Meyer EW 66, Pedersen KZ 33, 1897, 547, Barić ARS I 33, Tagliavini AD 203, Çabej SF 4, 1964, 87, Orel AED 285, Topalli Dift. 100).

**néjse** psz. “s’ka gjë, sidoqoftë, s’prish punë”. Fjalë kryesisht e geg. VP., që ka edhe format *ndojse*, *nojse*, *nojsesi* (Gazulli). Sipas këtij materiali, mund të jetë formim i brendshëm i gjuhës me përngjitje: *ndoj se* me kuptimin “s’ka ndonjë send (gjë)”. Dizdari e ka për huazim nga turq. *ne isé* “çkado qoftë”. (Mann Gr. 209, Topalli Theksi 409, Dizdari 709).

**nepërkë** f. “gjarpër helmues, me kokën si trekëndësh e të shtypur, me trupin me luspa me ngjyra të ndryshme, lat. *Vipera berus*”. Fjalë e mbarë gjuhës me burim të errët, e përdorur më shumë në dialektin toskë, ku del me një larmi trajtash, si: *nëpërkë*, *neperkë*, *nepkër*, *nepërtkë*, arb. e Italisë *neprëmtë*, arb. e Greqisë *nepërtë*, *njëpërtë* etj. Nga format e shumta, *nepërtkë* ka qenë forma bazë, ku ka rënë *-t-*ja në një grup prej tri bashkëtingëlloresh (Çabej). Fjalën e ka edhe rumanishtja: *năpîrca*, *napîrtica*, prandaj s’përjashtohet burimi nga një bazë latine. Mund të jetë e formuar nga lat. *pertica* “shkop i gjatë e i hollë, purtekë” sipas ngjashmërisë fizike të gjarprit. Rrjedhojë e emrit është folja *nëpërkoj* “gjarproj, dredhoj” nisur nga kuptimi “eci si nepërkë”. Prej shqipes ka depërtuar në disa të folme maqedonase. (Stier nr. 146, Camarda I 340, Meyer EW 303, Weigand Wört. 61, La Piana SLA I 115, Orel AED 290, Çabej SE VI 45).

**ngacmój** fol. “ngas me dorë, cys; nxit”. Fjalë e mbarë gjuhës. Për burimin e saj, ndryshe nga Çabej, që e nxjerr nga *ngallc* “ngallicë e qepës” ose nga *gacë* “thëngjill”, mendojmë se *ngacmoj* është formim i brendshëm me prapashtesat *m-* dhe *-o* nga folja *ngas*, që përdoret edhe me kuptimin “ngacmoj” dhe ka krijuar rrjedhojat *ngasë* “padurim” e *ngasje* “tundim,

ngacmim”. Te *ngacmoj* sonantja *-m-* e ka kthyer fërkimoren në afrikate (*-s- > -c-*). Rrjedhoja të fjalës janë: *ngacmim*, *mbingacmim* e *ngacmimtar*; *ngacmues*, *i ngacmueshëm* e *ngacmueshmëri*. (Walde-Pokorny I 668, Orel AED 292, Çabej SE VI 54, Luka III 224).

**ngadalë** ndf. “pa u nxituar, jo shpejt”. Fjalë e mbarë gjuhës, format e së cilës lidhen me ndajfoljen *nga*: *ngadalë* në toskërishte ku ka *nga*; *kadalë* në gegërishte ku ka *ka(h)*. Gegërishtja ka edhe *kadal-kadalë*, me përsëritje të ndajfoljes. Është formim i brendshëm me ndajfoljen *nga* dhe foljen (*n*)*dal* “qëndroj, ndaloj”. Kësisoj, *ngadalë* ka kuptimin “me ndalesa, duke u ndalur”. Elementi *-dalë* i ndajfoljes *ngadalë* lidhet përbrenda gjuhës me *dale* “prit, ndal, mos u ngut”, një fjalë-fjali e dialektit toskë me një folje në mënyrën urdhërore dhe një trajtë të shkurtër përemërore. Përjashta shqipes, bashkë me *dale* e *ndal*, lidhet me gjerm. *halten* “mbaj, ndal”, kelt. (kymr.) *dâl*, *dala*, *daly* “mbaj”. Rrjedhoja të fjalës janë: *ngadalësoj*, *ngadalësim*, *ngadalësi*, *ngadalësues*; *i ngadalshëm* e *ngadalshmëri*, *i ngadaltë*.

**ngajë** f. “shkak, arsye”. Fjalë me përhapje krahinore (Godin, Leotti). Është formim i brendshëm prej ndajfoljes *nga*, që ka marrë prapashtesën *-ë* dhe bashkëtingëlloren *-j-* për zhdukje të hiatit (khs. *blojë*, *drojë*); si rrjedhim, *ngajë* do të thotë “nga se, prej nga”. Kësisoj, *ngajë* afrohet për nga formimi dhe kuptimi me *shkak* nga *shka*, formë dialektore për “çka”.

**ngalem** fol. “më zihen këmbët e nuk eci dot”. Fjalë e mbarë gjuhës, me degëzime të shumta kuptimesh e formash; e trashëguar nga fondi indoeuropian. Lidhet përbrenda gjuhës me *ngel*, formim me metaforë duke qenë parësore *ngal*. Një lidhje tjetër brendagjuhësore është me foljet *shkal* e *shkel*, edhe këto me ndryshim zanoresh si *ngal* e *ngel*. Lidhja ndërmjet *ngal* e *shkal*, *ngel* e *shkel* është njëllor si *ngrij* e *shkrij*, *ngarkoj* e *shkarkoj*, ku foljet kanë marrë parashtesa të ndryshme, nganjëherë me kuptime të kundërta. Për vendosjen e fjalës në fushën indoeuropiane, ndryshe nga Çabej që e afroi me lat. *callum* “kallo, lëkurë e fortë” e sll. *kaliti* “kalit”, të gjitha këto folje lidhen me rrënjën *kel-*, *kol-* “qëlloj, godas”, ku bëjnë pjesë gr. *κολετρᾶν* “ec, shkel”, lit. *kalù*, *kálti* “qëlloj, godas”, një afrim që pajtohet kuptimisht e fonetakisht. Sipas gjuhëve të tjera, *shkal* e *shkel* duhet të jenë parësore ndaj *ngal* e *ngel*, duke shprehur të parat kuptimin e lëvizjes (“ec, shkel”), kurse të dytat kuptimin e kundërt, qëndrimin, ndalimin. Kështu ka ndodhur me foljet *shkatërroj* e *ngatërroj*, ku parësore është *shkatërroj*, nga numri *katër*, kurse folja *ngatërroj*, antonimi i saj, është dytësore. Rrjedhoja të fjalës janë: *i ngalët* “që mezi ecën”, *ngalakaq* “i ngadalshëm në lëvizje, i plogët, i ngathët” me prapashtesat *-ak* + *-aq*; *ngalëz* e *ngalsë* “pengesë, ngatërresë”, *ngaløj* e *ngalosem* “ngalem”, *ngalosë* “sëmundje që u bie dhëve e dhive dhe u prek kyçet e këmbëve, sytë dhe gjinjtë”, *ngalës* e *ngalc* “çarku i pushkës” etj.

(Meyer EW 305, Helbig 23, Spitzer MRIW I 1914, 142, Jokl Stud. 78, Walde-Pokorny I 437, Çabej SF 4, 1964, 96, Orel AED 292, Luka III 225).

**ngallmój** fol. “mbërthej bashkë pjesë druri, duke i futur një rën të tjetra; puthit”. Fjalë kryesisht e dialektit gegë. Për burimin e saj, ndryshe nga Meyeri (nga it. *incalmare*), Jokli (nga *akull*) e Çabej (nga *kallî ~ kalliri*), mendojmë se *ngallmoj* lidhet etimologjikisht me *shkallmoj* “prish, shkatërroj”, me të cilën qëndron në raporte antonimike, kurse fonetkisht si *ngrij* e *shkrij*, *ngarkoj* e *shkarkoj*. Kësisoj, *ngallmoj* me kuptimin “fut (njërën pjesë të tjetra), mbërthej”, është një rrjedhojë e foljes *kall* “fut, shtie”, që ka marrë parashtesën *n-* dhe prapashtesën *-m*. Dëshmohet së pari te Budi, që ka antonimin e saj: *Qelbetë korpi i tyne, gjymtyrëshit çkallëmuom*. (Meyer EW 305, Jokl LKU 269, Çabej SF 4, 1964, 97, SE III 51, Haarmann Lat. Lehn. 130).

**ngas** fol. “vrapoj”, “prek diçka me dorë, cys, nguc, gërgas”. Fjalë e mbarë gjuhës, kuptimi i parë i së cilës është “vrapoj”, prej të cilit kanë dalë kuptimet e tjera. Është fjalë e trashëguar nga fondi indoeuropian. Lidhet me rrënjën *g<sup>h</sup>ā* “shkoj, vij”, ku bëjnë pjesë let. *gāju* “erdha”, ind. vj. *jīgāti* “shkon”. Ka marrë parashtesën *n(ē)-*. Mbaresat *-s ~ -t* të kohës së tashme janë dytësore. Format pa mbaresë dalin në pj. *nga / nga-rë* dhe në mënyrën urdhërore *nga*. Çabej e lidh përbrenda gjuhës me një *\*kas* të foljes *përkas* duke e afruar me lat. *quatio* “tund, shkund”; por folja *përkas* ka dalë nga *prek*, ku mbaresat *-as ~ -et* janë dytësore, ashtu siç janë të tilla edhe mbaresat *-s ~ -t* te *ngas ~ nget*. Dëshmohet së pari te Buzuku: *e mos presë aj me klenë engām en kujnaj*. Rrjedhoja të fjalës janë: a) nga e tashmja *ngas*: **ngasë** “padurim” e **ngasje** “tundim”, **ngasës** “gërgasës”; b) nga pjesorja *nga-rë*: **ngarës** “ai që tremb gjahun dhe ua çon gjahtarëve në pritë”, **i pangarë** “i paprekur” e **i pangashëm** “i paprekshëm”, **ngaraz** “duke e hedhur farën e misrit me një parmendë të dytë”. (Bopp 524, Camarda I 40, Berneker I 581, Weigand Wört. 61, Meyer EW 305, Pedersen KZ 36, 1900, 331, Walde-Pokorny I 677, Barić ARS I 31, Tagliavini AD 205, Vasmer REW I 640, Demiraj AE 295, Orel AED 292, Çabej SE VI 52, 59).

**ngashëréj** fol. “prek në zemër, mallëngjej”. Fjalë e dialektit toskë, e përgjithësuar në shqipen e sotme. Ka edhe formën *ngashëroj* me një paradigmë tjetër zgjedhimi, e cila lidhet përbrenda gjuhës me geg. **gashnoj** “qaj me ngashërim” duke qenë *ngashëroj* forma me rotacizëm e toskërishtes. Pa shpjegim etimologjik te Meyeri e Çabej. Nga krahasimi i formave të dy dialekteve, trajta bazë është *ngashënoj*, që është formim me parashtesat *n-* + *ga-* (një variant i parashtesës *gē-*) nga folja *\*shënoj*, huazim prej lat. *sanāre* “shëroj”. Kësisoj, *ngashëroj* e *ngashërej* lidhen përbrenda gjuhës me *shëroj*, një fjalë që i mungon gegërishtes me këtë kuptim, por e ka edhe ajo te folja *gashënoj*. Dialekti i Veriut ka edhe forma të tjera të kësaj foljeje: *me gashnye*

“me thithë, me tërheqë” (Bashkimi) e *me ngashënjye* “me joshë, me tërhjekë për vedi”, që kanë hyrë në paradigmen e foljeve me *-enj* (ashtu si tosk. *ngashërej*), duke u ndikuar *ngashënjej* nga foljet e kësaj paradigme për bashkëtingëlloren *-nj-* në vend të *-n-së* (khs. *mallënjej*, *ngadhënjej*, *gënjej*). Forma të tjera të gegërishtes janë: *m’u gashë* “me çue lakmi” (Logoreci), e krijuar me rrugë prapashkuese nga *gashënoj* a *gashënjej*; prej së cilës janë krijuar foljet *me gashmue* (Logoreci) me prapashtesën *-m* dhe *me gashye* duke u ndikuar nga *gashnye* e *gashnnye*. Rrjedhoja të fjalës janë: **ngashërim**, **ngashëri** e **ngashërues** nga forma e toskërishtes; **ngashnjim** e **ngashënjyes** nga forma e gegërishtes. (Meyer EW 305, Orel AED 294, Çabej SE VI 60).

**ngec** fol. “mbetem në vend e nuk lëviz për shkak të një pengese”. Fjalë e mbarë gjuhës me burim të paqartë. Lidhet përbrenda shqipës, nga njëra anë me **ngac** me të njëjtin kuptim (Bashkimi) duke qenë në marrëdhënie metafonie, nga ana tjetër me **shkec** me kuptimin “lirohëm, çlirohëm” (Kristoforidhi) duke qenë në marrëdhënie antonimike (khs. *ngjit* ~ *shqit*, *ngrij* ~ *shkrij*). Në këto forma, ato me zanoren *-a-* janë parësore, kurse ato me *-e-* janë dytësore, çka e dëshmon mungesa e kthimit të grykoreve në qiellzore. Për burimin e fjalës, *ngec* lidhet përbrenda gjuhës me *ngal* ~ *ngel*, ku ka rënë lëngëzoria para afrikates (*\*ngel-c* > *ngec*). Kuptimisht, *ngel* e *ngec* janë sinonime. Çabej e lidh me *ngath*. Rrjedhoja të fjalës janë: **ngecje** me prapashtesën *-je*, **ngecë** “vend me baltë ku *ngec* një njeri a një kafshë” me prapashtesën *-ë* (khs. *dekë*, *veshë*, *mbathë*); **ngecull** “pengesë” me prapashtesën *-ull*. (Bugge BB XVIII 1891, 175, Meyer EW 122, Kristoforidhi 330, Orel AED 294, Çabej SE VI 63, Luka III 234).

**ngërdhucem** fol. “përdredh buzët, ngërdheshem, kërcënoj, kërcëllit dhëmbët”. Fjalë e dialektit gegë. Lidhet përbrenda gjuhës me *ngërdheshem* me zëvendësim të rrokjes fundore me prapashtesën *-uc*, që është shtrirë prej emrave në sistemin foljor. Dëshmohet së pari te Budi: *e ngërdhuc djalli t atillë mkat me e bām*. Rrjedhoja **ngërdhucje** ka marrë prapashtesën *-je*. Çabej e nxjerr prej foljes *ngridhet* “vjen brumi i bukës”, “vjen në afsh për t’u ndërzyer”. (Çabej SE VI 64).

**ngul** fol. “fut brenda me forcë (një hu në dhe, një gozhdë në mur etj.)”. Fjalë e mbarë gjuhës duke përfshirë edhe arbërishten e diasporës; e trashëguar nga fondi indoeuropian. Rrënja e fjalës është *\*kul-* (khs. *shkul*), që ka marrë prapashtesën *n(ë)-*. Për burimin e fjalës, ndryshe nga Çabej, që nisët nga kuptimi “bie të flë” duke e lidhur me lit. *guliū* “bie në shtrat”, *gulta* “shtrofull”, mendojmë se rrënja *\*kul* ka pasur kuptimin e parë “godas (për të ngulur diçka)” duke u lidhur përbrenda gjuhës me foljen *sjell*, njëri nga kuptimet e së cilës është “godas, gjuaj”; khs. *mos sill* “mos gjuaj (me gurë), mos më bie (shpullë), mos më godit”. Fonetikisht, *sjell* e *\*kul* janë forma me lidhje

apofonike: *sjell* nga ie. *q<sup>l</sup>el-* me buzoprapaqiellzore para një zanore të çelët, që ka kaluar në fërkimore; kurse *\*kul* nga ie. *q<sup>u</sup>ol-* me buzoprapaqiellzore para një zanoreje të mbyllët (khs. edhe *përkul*). Folja dëshmohet te Bogdani: *kur u ngul Kryqja*. Rrjedhoja të fjalës janë: emrat *ngulje* e *ngulm* e dyta për “zell, këmbëngulje” me prapashtesën *-m*, që ka krijuar *ngulmoj*, *ngulmim*, *ngulmues* e *ngulmueshëm*; *nguloj* e *ngulim*, e fundit neologjizëm për “koloni”; mbiemrat *i ngulët*, *i ngulmët* e *i ngulshëm*; ndajfoljet *ngulas*, *ngultas*, *ngulazi* e *ngulthi*; folja *ngulit* me rrjedhojat *ngulitje* (me prapashtesën *-je*), *ngulitës* (me prapashtesën *-s*) etj. (Meyer EW 307, AS III 4, Pušcariu EW 1559, Weigand BA III 1927, 112, Meyer-Lübke REW 2355a, Tagliavini AD 206, Orel AED 297, Çabej SE VI 77).

**ngut / ngus** fol. “nxitj, shtyj për një punë”. Fjalë e dialektit gegë, e përgjithësuar në shqipen e sotme. Për burimin e saj, ndryshe nga Çabej, që e lidh me *ngridhet*, *ngërdhej* e *ngërdhuc*, mendojmë se *ngut* bën pjesë në një familje tjetër fjalësh duke u lidhur përbrenda gjuhës me *nguc*, *cyt* e *nxit*, që kanë për bazë rrënjën ie. *g<sup>h</sup>ejō* “jetoj” (shq. *\*g<sup>h</sup>i-t*, *\*g<sup>h</sup>o-t*), ku bëjnë pjesë let. *dzīt* “shëroj”, sll. vj. *žiti* “jetoj”, ind. vj. *jīrā-* “i gjallë, i vrullshëm”. Fjalët me grykore (*ngut*, *nguc*) kanë pasur në rrënjë zanore të mbyllët, që i ka ruajtur grykoret të pandryshuara; kurse ato me fërkimore e afrikate (*nxit*, *cyt*) kanë pasur zanore të çelët, që i ka kthyer grykoret në fërkimore. Ndryshimet e zanoreve të brendshme reflektojnë forma me apofoni kualitative. Bashkëtingëlloret e ndryshme fundore (*ngut* ~ *ngus*) janë krijuar nga mbaresat foljore (khs. *mat* ~ *mas*). Dëshmohet së pari te Budi: *tue qenë puna për të ngutunë* (DC). Rrjedhoja të fjalës janë: emrat *ngut* “nxitim”, *ngutje* e *ngutësi*; mbiemri *i ngutshëm*, që e kanë Budi e Bardhi, folja *përngutem*, ndajfolja *ngutthi* etj. (Meyer EW 307, Vasmer Wort. 46, Orel AED 297, Çabej SE VI 80).

## NJ

**një** num. “numri i parë në vargun e numrave të plotë”. Fjalë e mbarë gjuhës, me burim të trashëguar. Ndër trajtat e ndryshme që kanë të folmet e shqipes, *nja* është e gegërishtes veriore, *një* është e toskërishtes dhe e Buzukut, e përgjithësuar në shqipen e sotme; *nji* është e gegërishtes së sotme. Lidhet me numrin “një” të indoeuropianishtes, duke u afruar me gr. ἕν, lat. *unus*, irl. vj. *ōen*, got. e prus. vj. *ains*. Forma e shqipes shpjegohet fonetikisht nga një *onjóm* e rasës kallëzore (Jokl), me shpërngulje theksi në mbaresë, që ka dhënë rregullisht *njâ* (geg.) / *një* (tosk.) me rënien e zanores së patheksuar nistore dhe kthimin *-o-* > *-a-*. Forma *një* e Buzukut shpjegohet me pozicionin e patheksuar të fjalës te numërorët e përbërë (*njëmbëdhjetë*, *njëqind*) dhe në sintagmat me një emër (*një djálë*). Madje, me këtë pozicion shpjegohet edhe zanorja e shkurtër e numërorit, përkundrajt zanores së gjatë të temave emërore e foljore

(khs. *zâ ~ zë, u bâ ~ u bë*). Por ky autor ka edhe formën *nja*, kur del si fjalë e theksuar te përemrat e pacaktuar: *tue dashunë mirë njani tjetërinë*. Forma *nji* është krijuar më vonë nga kthimi i zanores së rregjuar *-ë* në *-i* nga veprimi asimilues i bashkëtingëllores qiellzore *nj-* (khs. *qi* nga *që*). Fjala dëshmohet së pari në Fjalorthin e kalorësit gjerman Arnold von Harff: *geneyre* “eyn man - një njeri”; *nijtgint* “hundert - njëqind”; *nemijgo* “dusent - njëmijë”. E ka edhe Buzuku: *Një njeri pat dy bij*. Te Budi gjenden tri forma të këtij numërori: *një, nja, nji*, çka dëshmon se forma *nji* e gegërishtes së sotme është krijuar së paku që në shek. XVII. Te Buzuku ky numëror del edhe me forma të lakuara: *E u afëruo njëj bujari së qytetsë s atë dhej*. Forma të tilla kanë edhe të folmet jugore të toskërishtes: *njëj hamallit* (çam.). Në ndryshimet e këtij numërori, gegërishtja ka shkuar edhe një hap më tej, duke krijuar një formë të reduktuar, që përdoret vetëm si njëj, domethënë e shoqëruar me një emër: *edhe i nuse e paska zanë; e i muranë të bukur, qi m'ja vndojnë tu kryet*. Ky raport trajtash ndërmjet numërorit e njëj është i njohur edhe në gjuhë të tjera; khs. ang. *one* “një”, por *an apple* “një mollë”, *a pear* “një dardhë”. Sikurse shihet, me format e ndryshme të këtij numërori (*nja, një, nji, i*) gegërishtja paraqitet më inovuese, kurse toskërishtja me formën e vetme *një* paraqitet më e njësishtme dhe më konservative. Rrjedhoja të fjalës janë: *njëjës*, e krijuar sipas *shumës* me prapashtesën *-(ë)s* dhe bashkëtingëlloren *-j-* për zhdukje të hiatit; *njëjësi, njëjësoj* e *njëjësim*; *i njëjtë, njëjtësi, njëjtësoj, njëjtësim; njëzaj* me prapashtesën deminutive dhe shtesën *-aj* (khs. *këndenaj*), *njëmëzaj* me prapashtesat *-m + -zë, njëmësht* me prapashtesat *-m + -(ë)sht*; *njësi* me prapashtesën *-si*, prej kësaj *njësoj* “bashkoj”, *njësim, i njësishtëm, njësisht* “njësoj”, *njësor* “i njësishtëm”; *njësh* me mbasesën e rrjedhores shumë, të krijuar në analogji me *dysh, tresh; njëzaj* e *njëzim* me prapashtesën *-zo; njëckë* me prapashtesën *-ckë; mënjëzaj* me prapashtesën *më-*, prapashtesën deminutive dhe shtesën *-aj*; kompozitat e përngjitjet e shumta, si: *njënjë* “baras”, *njëfish, njëfarë, njëherë, njëlloj, njësoj, njëmend* etj. (Bugge BB XVIII 1891, 168, Meyer AS II 73, EW 313, Jokl IF 36, 1915, 114, Walde-Pokorny I 101, Barić ARS I 64, La Piana SLA Varia 77, Huld BAE 101, Demiraj Sist. num. 17, Orel AED 304, Çabej SE VI 103, Topalli Theksi 351, Gr. 673).

**njom** fol. “e lag, e zbut diçka në ujë”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga fondi indoeuropian. Për burimin e saj, ndryshe nga Çabej, që e lidh me foljen *ngjyey*, duhet mbajtur parasysh se bashkëtingëlloja *nj-* nuk vjen nga një *\*ngj-* a *\*ngl-*, meqenëse autorët e vjetër, të folmet skajore të toskërishtes (çam.) dhe arbërishtja e diasporës e kanë me *nj-*; si rrjedhim, *nj-ja* ka dalë nga *n-* + *-j*, si te numërori *një* ose si në format e shumës *hunj, drunj*. Në këto rrethana, *njom* afrohet me mbiemrin “i ri” të gjuhëve indoeuropiane nga rrënja *neuos, -ios* (shq. *\*një-m*), ku bëjnë pjesë ind. vj. *návya-*, gr. (jon.) *veîoç*, gal. *Nevio-*, got. *niuvis*, të gjitha me kuptimin “i ri”. Kuptimisht “i ri”

dhe “i njomë” përputhen; khs. *njome* “fëmijë, foshnjë”, *njomëz* “filiz i ri”, në epikën legjendare: - *Amanet ku je, mori njomzëja e ahit*; *njomëzak* “fëmijë”; te Bogdani: *burrit vet, qi dviq i njomë* “giovinetto”. Dëshmohet së pari te Buzuku: *kur ju shihni se glembi i tî mer me ɥ njomunë*; *Djelmtë e tû porsî njomëzatë qi qet ullini përçark veti*; Budi: *me bār e me gjeth të njomë* (SC). Rrjedhoja të tjera janë: *i njomë, njomje, njomës, njomësi, njomësirë, njomësira* “barishte”, *njomësoj* “përtërij, ardhang”; *njomsh* “bar i njomë”, *njomak* “kalli misri i papjekur”, *i njomësht* (khs. *i lagësht*), *njomështi, njomështirë e njomështoj; njomishte* “barishte të njoma”, *njomurina, njomor* etj. (Meyer EW 314, Jokl Stud. 66, Walde-Pokorny I 361, Walde-Hofmann I 617, Çabej SF 4, 1964, 109, Demiraj AE 306, Orel AED 305).

## SUMMARY

## FROM ETYMOLOGICAL DICTIONARY OF ALBANIAN V

**lakút** < *la-* + *kut*; **lapér** < *lapë* + *-er*; **lapurák** < *lapër* + *-ak*; **lauréshë** “*Alauda cristata* < *lahur* + *-eshë*; **lej**: IE. \**leud<sup>h</sup>*-, Old Ind. *rōdhati, rōhati*, Lat. *liberōrum*, got. *liudan*, OCS *ljudъje* (Jokl). **lérë** < *lyej*, cf. *ngjyey* ~ *ngjyrë*; **lë**: IE. *lē(i)d-*, Got. *lētan*, Germ. *lassen*, Old Nord. *latr*, Lat. *lassus*, Gr. *ληδεῖν*; **lëbógër** < *blokë* + *-r*; **lëpë-ja** < *lapë* + *-in(ë)*; **lëvózhgë** < *lë-vosh-gë*; **lëvrínj** < *lëvroj* + *-inj*; **lódër**: IE. *lēud<sup>h</sup>*- + *-r*, Old Ir. *luaid, imluadi*; **luár** ~ **lóri** < *lë-* + *var*; **lýej**: IE. *leu-*, Gr. *λῦμα*, Lat. *polluo, lutum*, Old Ir. *loth*, Cym. *lludedic*; **llabáne** < *llapë* + *-an*; **llacamán** < *llasë* + *-man*; **macúrr** < *ma-* + *curr*; **macarrúngë** < *macurr* + *-ungë*; **makth** < *m* + *ankth*; **malcój** < It. *male* + *-(ë)so*; **marxhë** < It. *marcio*; **mashtroj** < It. *ammaestrare*; **mashúrka** < *masur* + *-kë*; **mavrí** < Mod. Gr. *μαῦρος*; **(i) mbárë** < *i parë*; **mbërdhók** < *m-* + *papërdhok*; **mbërthéj** < *m-* + *për-thej* (cf. *zbërthej*); **mbërríj** < *rri*: IE. *rē*, Old Nord. *rō*, Ags. *rōw*, OHG *ruowa*; **mbështét / mbështés** : *mbë-* + *shtet* ~ *shtat*; **mbles** < *ble(j)* + *-s*; **(i) mbrámë** < *i prapmë* (*prapë* + *-më*); **mbulój** < *m-* + *bulë* + *-o(j)*, cf. *zbuloj*; **më / mâ**: IE. *mei-* (Alb. \**mei-no*), Lat. *minor, minus*, Ags. *minn*; **mëngój** < *më-në-ag-o*; **mëshére** < *peshë* + *-er*; **mështymet** < *më* + *pështymë*; **mjákë** < *makë*: IE. *mak-*, Old. Bulg. *mokrъ*, Lit. *mākas, mēkeris*, Cym. *megin*, OHG *mago*; **mýjë** < *mye*: IE. *med<sup>h</sup>*-, Old Ind. *madhya*, Av. *maidya*, Arm. *měã*, Gr. *μέσσος*, Lat. *medius*, Got. *midjis*; **ndërgón** < *ndrag*; **ndërséj** < *n(d)ë-* + *arsej*; **ndíej**: IE. *der-*, Gr. *δέρω, δέρμα*, Bret. *dervoeden*, Ags. *teter*, Lit. *dedervinê*, OCS *derp*; **nějse** < *ndoj se*; **nepërkë** < Rum. *năpîrca, napîrtica*; **ngacmój** < *ngas* + *-m* + *-o(j)*; **ngadálë** < *nga* + *dal* (cf. Tosk *dale*); **ngájë** < *nga-j-ë*; **ngálem**: IE. *kel-, kol-*, Gr. *κολετρῶν*, Lit. *kalù, kálti*; **ngallmój**: *n-kall-m-o(j)*; **ngas**: IE. *g<sup>u</sup>ā*, Let. *gāju*, Old Ind. *jígāti*;

**ngashëréj** < *ga-* + Lat. *sanāre* (cf. *shëroj*); **ngec** < *ngel-c* (cf. *ngac*); **ngërdhúcem** < *ngërdheshem* (+ *-uc*); **ngul** < *\*kul-* (cf. *shkul*): IE. *q<sup>h</sup>el-* / *q<sup>h</sup>ol-*; **ngut** / **ngus** IE. *g<sup>h</sup>eǵō* (Alb. *\*g<sup>h</sup>i-t*, *\*g<sup>h</sup>o-t*), Let. *dzît*, OCS *žiti*, Old Ind. *jīrā-*; **një**: IE. *onǵóm*, Gr. *οἷνη*, Lat. *unus*, Old Irl. *ōen*, Got. *ains*; **njom**: IE. *neuos-*, *ǵios* (Alb. *\*njē-m*), Old Ind. *nāvya-*, Gr. (Ion.) *veĩos*, Gal. *Nevio-*, Got. *niujis*.